



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 787 Prot.

Tiranë, më datë 21.06 2022

VENDIM

Nr. 287, datë 21.06.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 21.06.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Rijetësimi i objektit 2 kate dhe podrum, sistemim i jashtëm dhe mur rrethues”, Brenda Kufirit Qendër Historike Gjirokastër, me aplikues dhe zhvillues Hevjola Sherifi;
2. Në vijim të Vendimit të KKA Nr. 254, datë 13.12.2017 të realizohet gërmimi arkeologjik i shpëtimit në zonën jug - perëndimore të pronës ku parashikohet të realizohet muri rrethues dhe sistemimi i jashtëm dhe rezultatet e gërmimit arkeologjik të paraqiten për shqyrtim në KKTKM;
3. Për realizimin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit, Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
4. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ;
6. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOFO

